

## **D E K R E T**

Në mbështetje t'art. 54, nr. 4 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipëris dhe të nenit 4, nr. 10 të Ligjës nr. 363 datë 26-11-1946 mbi Presidiumin e Kuvendit Popullor;

Mbi propozimin e Qeverisë,

Presidiumi i Kuvendit Popullor

## **S H P A L L :**

Dekret-ligjën me titull e përmbajtje si vijon:

Dekret-Ligjë Nr. 743 Datë 26 11 1949 Mbi Komunitetet Fetare.

### **Neni 1.**

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë të gjithë Shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit.

### **Neni 2.**

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë besimet, si komunitete fetare, janë të ndara nga Shteti.

### **Neni 3**

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë është i ndaluar përdorimi i Kishës dhe i fesë për qëllime politike si edhe formimi i organizatave politike me baza fetare.

### **Neni 4.**

Në konformitet me nenin 13 të Statutit të Rpublikës Popullore të Shqipërisë është i ndaluar çdo provokim për urrejtje fetare.

### **Neni 5.**

Asnjëri nuk mund të ndiqet, as t'i kufizohen të drejtat e tija civile dhe as të përjashtohet nga detyrimet e tij që i imponojnë ligjet e Shtetit, për shkak se i përket njerit ose tjetrit besim ose pse nuk bën pjesë në asnjë besim. Kjo vlen edhe për funksionarët fetare të besimeve të ndryshme.

#### **Neni 6.**

Komunitetet fetare janë të lira t'organizohen dhe t'ushtrojnë lirisht cremoitet dhe shërbimet fetare në bazë të dogmave, kanoneve dhe statuteve të tyre në qoftë se këto nuk vijnë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira.

#### **Neni 7.**

Komunitetet fetare që të munt të organizohen dhe të funksionojnë duhet të njihen nga Shteti. Njohja bëhet me aprovim e statutit të tyre nga Presidiumi i Kuvendit Popullor mbi propozimin e Qeverisë.

Me aprovimin e Statutit komunitetet fetare dhe degat e tyre locale fitojnë cilësinë e personit juridik dhe gëzojnë të gjitha të drejtat relative në konformitet me këtë Dekret-ligj dhe ligjet e tjera të Shtetit.

Statuti i komunitetit fetar duhet të përmbajë sistemin e organizimit, të drejtimit dhe t'administratimit të tij. Rregulloret e nxjerra në bazë të Statutit duhet t'aprovohen nga Këshilli i Ministrave.

Njohja e komunitetit fetare munt të revokohet me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi propozimin e Qeverisë kur me veprimtarinë e tij ka shkelur ligjet e Shtetit, rendin public dhe zakonet e mira.

#### **Neni 8.**

Me përjashtimin e sektit bektashian që formon komunitet fetarë më vehte, sektet e ndryshme fetare bëjnë pjesë në komunitetin fetar përkatës.

Sektet fetare organizohen dhe veprojnë në bazë të traditave dhe të rregulloreve të tyre në qoftë se këto nuk vijnë në kundërshtim me ligjet e Shtetit dhe rendin publik dhe zakonet e mira.

Rregulloret e sekteve fetare pasi të pranohen edhe nga organi më i lartë i komunitetit fetar në të cilin bën pjesë duhet t'aprovohen edhe nga Këshilli i Ministrave. Me këtë aprovim sektet fetare fitojnë cilësinë e personit juridik në vehte.

**Neni 9.**

Çdo komunitet fetar duhet të ketë një Kryesi që do të jetë përgjegjëse përpara Shtetit.

Lidhjet në mes të Komuniteteve fetare dhe të qeverisë bëhen me anë të kryesisë së Këshillit Ministerial.

**Neni 10.**

Komunitetet fetare munt të ndërtojnë dhe të hapin për nevojat e tyre faltore si dhe të ushtrojnë publikisht dhe në vënde të hapta ceremonitë, shërbimet dhe procedurimet e tyre fetare duke i nënshtruar ligjeve të përgjithëshme të Shtetit dhe rregulloreve administrative.

**Neni 11.**

Komunitetet fetare munt të thëresin Kongrese, sinodhe, konferenca dhe mbledhje të tjera të përgjithëshme ose locale për çështje të besimit të tyre duke iu nënshtruar ligjeve të përgjithëshme të Shtetit dhe rregulloreve administrative.

**Neni 12.**

Komunitetet fetare me aktivitetin e tyre dueht të zhvillojnë në besimetarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të shqipërisë si dhe të forcojnë bashkimin kombëtar.

**Neni 13.**

Kryetarët e Komuniteteve fetare, funksionarë fetarë dhe të gjithë personat në shërbim të komuniteteve fetare duhet të jenë shtetas shqiptarë besnikë të popullit dhe të shtetit, të ndershëm dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat civile.

Kryetarët e komuniteteve fetare dhe të sekteve fetare, Kryemiftiu, mystinjtë, dhe nënmysftinjtë, kryegjyshi dhe gjyshërit, kryepiskopi, episkopët, dhe arhimandritët, arkipeshvi dhe ipeshkvit dhe ndihmësat e tyre imediatë, pasi të zgjidhen ose të emërohen nga organet fetare kompentente duhet të aprovohen nga Keshilli i Ministerial.

Kryetarët e sekteve fetare të ndryshme pasi të zgjidhen ose të emërohen nga organet kompetente në bazë të rregullores së tyre, duhet të'aprovohen nga Kryesia e Këshillit Ministerial.

Funksionarët fetarë që kanë raporte kanonike me vëndet e jashtëme nuk mund të hyjnë në shërbim pa qenë t' autorizuar më parë nga Këshilli i Ministrave.

#### **Neni 14.**

Komunitetet fetare nuk muntt' ushtrojnë asnjë lloj juridiksioni. Në konformitet me dogmat dhe kanonet e tyre ata mund të kenë vetëm organe disiplinore për funksionarët fetarë dhe për personelin tjetër në shërbim të tyre.

Organizimi dhe proçedura për organet disiplinore të sipërme caktohen në Statutin e komunitetit fetar.

Dënimet disiplinore e dhëna mbeten pa ndonjë efekt në qoftë se janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin public dhe zakonet e mira.

#### **Neni 15.**

Kryetarët e komuniteteve fetare, funksionarët fetarë si dhe të gjithë funksionarët e tjerë në shërbim t' instituteve të ndryshme fetare, që shkelin ligjet e Shtetit, rendin public dhe zakonet e mira ose që zhvillojnë ndonjë aktivitet anti demokratik, pamvarësisht nga përgjegjësjja tjetër, me propozimin e Kryesisë së Këshillit Ministerial mund te pezullohen nga shërbimin ose të pushohen.

Pezullimi nga shërbimi ose pushimi bëhet me njëherë nga organi fetar competent me të marrë propozimin e kryesisë së Këshillit Ministerial.

Në qoftë se organi fetar competent nuk merr vendim për pezullimin ose pushimin e funksionarit fetar, ky largohet nga detyra me udhë administrative.

#### **Neni 16.**

Komunitetet fetare nxjerrin t' ardhura dhe bëjnë shpenzime në bazë të buxheteve të tyre të pregatitura në konformitet me statutet e tyre.

Kur komunitetet fetare kanë nevojë, Shteti mund t'i ndihmojë materialisht.

Komunitetet fetare, buxhetet e tyre ja paraqisin Këshillit të Ministrave për aprovim.

Veprimtaria financiare e komuniteteve fetare kontrollohet nga organet financiare të Shtetit po n'atë mënyrë që kontrollohen të gjitha organizatat shoqrore të vendit.

#### **Neni 17.**

Komunitetet fetare nuk mund të hapin ose të mbajnë shkolla t'arsimt të përgjithshëm. Me autorizimin e Këshillit Ministerial ato mund të hapin dhe të mbajnë shkolla të mesme ose të larta fetare për përgatitien e funksionarëve fetarë.

Organizimi dhe programet e instituteve shkollave fetare caktohen me rregullore të veçantë t'aprovuar nga Këshilli Ministerial.

Dërgimi i të rinjve për studime në shkolla fetare jashtë Shtetit lejohet vetëm me autorizimin e Këshillit Ministerial.

#### **Neni 18.**

Të gjitha organet e komuniteteve fetare detyrohen t'i dërgojnë me njëherë për dijeni Kryesisë së Këshillit Ministerial letrat pastorale (mesazhet), qarkoret me karakter të përgjithëshëm dhe çdo botim public të përgatitur prej tyre.

Këshilli Ministerial mund të ndalojë shpalljen, shtypjen dhe shpërndarjen e letrave, qarkoreve dhe botimeve të sipërme nq qoftë se janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin public dhe zakonet e mira.

#### **Neni 19.**

Organet drejtonjës qëndrore të komuniteteve fetare duhet të jenë të regjistruara në Kryesin e Këshillit Ministerial kurse organet drejtonjëse të degëve locale dhe të sekteve fetare të ndryshme duhet të jenë të regjistruar në Këshillat popullore locale, duke u shënuar emër për emër antarët e organeve drejtuese.

**Neni 20.**

Në raportet midis komuniteteve fetare dhe organeve të Pushtetit ose administrates shtetnore si dhe në sekretariatit e komuniteteve fetare të ndryshme si gjuhë zyrtare do të përdoret gjuha shqipe.

**Neni 21.**

Të përmendurit e organeve më të larta të pushtetit dhe të administratës shtetnore në shërbimet, ceremonitë dhe festat e ndryshme fetare mund të bëhen vetëm sipas fomulës së aprovuar më parë nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 22.**

Komunitetet fetare duhet t'i njoftojnë Kryesisë së Këshillit Ministerial mbishkrimet, shenjat simbolike dhe vulat që përdorin.

**Neni 23.**

Formimi i shoqatave dhe i organizatave me qëllime fetare-morale si dhe botimi i librave për mësim fetare iu shtrohen ligjeve të përgjithëshme të Shtetit dhe rregulloreve administrative.

Aktiviteti i shoqatave dhe organizatave fetare dueht të zhvillohet në baza kombëtare duke ju shërbyer interesave të popullit dhe të Shtetit dhe funksionarët e tyre duhet të jenë besnik të popullit dhe të Shtetit.

Edukimi dhe organizimi i fëmijve dhe të rinjëve, në konformitet me nenin 28 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, bëhet nën kujdesin e veçantë të Shtetit dhe prandaj nuk munt të merren me këtë veprimtari komunitetet fetare dhe funksionarët e tyre.

**Neni 24.**

Komunitetet fetare nuk mund të hapin spitale, jetimore dhe institute të tjera analloge.

Institutet e llojit të sipërm që mund t'ekzistojnë ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Dekres-ligje, shtetëzohen pa shpërblim me gjithë pasurit e tyre të luajtëshme dhe të paluajtëshme dhe kalojnë nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë ose të Drejtorisë për Kujdesin Social.

**Neni 25.**

Komunitetet fetare mund të kenë lidhje me komunitete fetare, institute, organizata dhe persona zyrtarë që kanë qendrën ose banimin e tyre jashtë Shtetit, vetëm me autorizimin e mëparshëm të Këshillit Ministrial dhe me anë të Ministrisë P. të Jashtëme.

**Neni 26.**

Komunitetet fetare ose degët e tyre (urdhëra, shoqata, misione fetare etj.) që kanë qendrën e tyre jashtë Shtetit nuk mund të hapin në Republikën Popullore të Shqipërisë dega të tyre (urdhëra, misione, institute mirëbërëse etj.) dhe ato që ekzistojnë mbyllen brenda një të muaj nga hyrja në fuqi të kësaj Dekret ligje.

**Neni 27.**

Komunitetet fetare nuk mund të marrin ndihma material dhe dhurata nga vendet e huaja në çdo formë dhe në çdo mënyrë që të jetë që të dërgojnë në këto vende veçse me autorizimin e Këshillit Ministerial.

**Neni 28**

Komunitetet fetare që kanë pasuri në vende të huaja, kur lidhin marrëveshje për këto pasuri përfaqësohen nga Ministrija e P. të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Gjithashtu kjo Ministri mbron në vendet e huaja interes fetare të shtetasve shqipëtarë.

**Neni 29.**

Pasurija e Komuniteteve fetare të çdukura ose t'atyre që u hiqet njohja i kalon Shtetit.

**Neni 30.**

Qendrat e komuniteteve fetare caktohen me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

**Neni 31.**

Çdo provokim për urrejtje fetare që bëhet me anë të fjalës, shtypit ose me menyra të tjera, dënhet me privim të lirisë jo më pak se një vit dhe me gjobë gjer në 10.000 lekë.

**Neni 32.**

Kushdo që me dhunë ose me frikësim ndalon shtetasit ose komunitetet fetare të njohura të ushtrojnë lirisht besimin e tyre dhe të kryejnë ceremonitë dhe shërbimet fetare që nuk shkelin ligjet e Shtetit, endin public dhe zakonet e mira, dënohet me privim të lirisë gjer në një vit.

Po me këtë dënim dënohet edhe ay që në mënyrën e sipërme shtrëngon ndonjë person që të marrë pjesë në ceremonitë dhe shërbimet fetare të ndonjë besimi.

**Neni 33.**

Kushdo që formon organizata politike me baza fetare si dhe ay që me anë të fjalës të shtypit ose me mënyra të tjera duke përdorur kishën dhe fenë bën propogandë kundra pushtetit popullor dhe masave të marra prej tij dënohet, në qoftë se vepra nuk formon ndonjë faj më të rëndë, me privim të lirisë jo më pak se një vit.

**Neni 34.**

Kryetarët e komuniteteve fetare si dhe të gjithë fundksionarët e tjerë fetarë që fillojnë nga detyra pa qenë aprovuar rregullisht, emërimi ose zgjedhja e tyre e sipas dispozitave të kësaj Dekret-ligje si dhe ata që të pushuar nga detyra fetare vazhdojnë t'a ushtrojnë këtë, dënohen me privim të lirisë gjer në 3 vjet.

**Neni 35.**

Komunitetet fetare detyrohen që brenda 3 muajve nga yrja në fuqi të kësaj Dekret'ligje t'i paraqesin Këshillit Ministerial për aprovim statutet e tyre të rregulluara në konformitet me dispozitat e kësaj Dekret-ligje.

Në qoftë se statutet e paraqitura përmbajnë dispozita në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin public dhe zakonet e mira, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund të kërkoj heqjen e tyre. Në qoftë se komuniteti fetar nuk konformohet me këtë kërkim, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund t'a refuzojë aprovimin e Statutit.

**Neni 36.**

Brënda 2 muajve nga hyrja në fuqi të kësaj Dekret ligje organiet udhëheqëse qendrore të komuniteteve fetare të ndryshme detyrohen t'i paraqesin Kryesisë së Këshillit Ministerial një listë me emrat e të gjithë funksionarëve fetarë të komunitetit të tyre.

Këta mund të mbeten në detyrat e tyre në qoftë se nuk ka ndonjë kundërshtim nga ana e Kryesisë së Këshillit ministerial. Kundërshtime mund të bëhen për ata funksionarë fetare që nuk i kanë cilësit e kërkuara prej kësaj Dekret-ligje.

**Neni 37.**

Kjo Dekret ligje hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë më 26 Nëntor 1949

Nr. I Dekretit: 963

Për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë

S e k r e t a r i :

(Sami Baholli) d v.

K r y e t a r i :

(Dr. Omer Nishani) d v